



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA E GJYKATËS DEÇAN

Numri i lëndës: 2022:205196

Datë: 08.03.2024

Numri i dokumentit: 05429362

C.nr.699/2022

GJYKATA THEMELORE NË PEJË, Dega në Deçan, Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari Bajram Cacaj, në çështjen juridike kontestimore të paditëses A. H., nga fshati P., K. e D., të cilën me autorizim e përfaqëson Sh. H., avokate në Deçan, kundër të paditurës Komuna e Deçanit, Drejtoria Komunale e Arsimit, me seli në Deçan, në çështjen juridike kompensim i pagës mbi bazën e përqindjes së inflacionit, me vlerë të kontestit 708,95 €, jashtë seancës, më datë 08.03.2024 mori këtë:

A K T G J Y K I M

- Për shkak të padëgjueshmërisë/mosbindjes –

APROVOHET në tërësi e bazuar kërkesëpadia e paditëses A. H. dhe DETYROHET e paditura Komuna e Deçanit, Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditëses t’ia paguaj në emër të pagesës shtesë - përqindjes së inflacionit shumë prej 708,95 €, shumë kjo e cila i referohet periudhave si në vijim:

- për periudhën janar-dhjetor 2021 shumë prej 171,76 €;
- për periudhën janar-nëntor 2022 shume prej 537,19 €,

të gjitha me kamatë ligjore prej 8% nga data 06.10.2022 (data e paraqitjes se padisë) deri në pagesën definitive si dhe shpenzimet e procedurës në shumë të përgjithshme prej 228,00 €, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, e nën kërcënimin e përmbarimit ligjor.

A r s y e t i m

Paditësja përmes të autorizuarës të saj, në padinë e parashtruar në gjykatë me datë 06.10.2022, si dhe parashtrësën për precizimin e padisë të datës 28.12.2023, ndër të tjera ka theksuar se

paditësja është punëtore e arsimit në Shkollën Fillore “S. V.” në fshatin P., K. e D., me kontratë të rregullt të punës, ku vazhdon të punoj edhe tani e tutje, kërkesën nga padija e bazon në obligimet që ka punëdhënësi ndaj paditëses që të paguhet mbi bazën e shkallës së inflacionit në vend, të dhëna këto që merren zyrtarisht nga Enti i Statistikave të Kosovës dhe kjo përqindje të futet në pagë, andaj ka kërkuar që të detyrohet e paditura që në emër të inflacionit për vitet 2021 dhe 2022, t’i paguaj paditëses shumën e përgjithshme prej 708,95 €, me kamatë ligjore prej 8%, si dhe i ka kërkuar shpenzimet e procedurës.

Gjykata në këtë çështje juridike kontestimore, pas shqyrtimit paraprak të padisë, ka nxjerrë aktvendimin për përgjigje në padi, C.nr.699/22 të datës 08.02.2024, me të cilin e ka detyruar të paditurën, që të përgjigjet në padi, të cilin e paditura e ka pranuar me datë 13.02.2024 (fakt i cili vërtetohet nga fletëdërgesa për dorëzim personal), duke e njoftuar të paditurën për detyrimin ligjor për dhënien e përgjigjes në padi dhe për pasojat ligjore që do të i ketë nëse nuk paraqet përgjigje në padi, përkatësisht për mundësinë që gjykata të marrë aktgjykim për shkak të mosbindjes.

E paditura pavarësisht se e ka pranuar aktvendimin për përgjigje në padi, së bashku me provat materiale, si dhe parashtrësën për precizimin e padisë, në këtë çështje juridike kontestuese, nuk ka paraqitur përgjigje në padi brenda afatit ligjor.

Gjykata pasi i ka vlerësuar kushtet ligjore për nxjerrjen e aktgjykimit për shkak të mos bindjes, ka gjetur se në rastin konkret, plotësohen të gjitha kushtet ligjore, për nxjerrjen e aktgjykimit në fjalë, nga neni 150 par. 1, pikat a), b) dhe c) të LPK, e cila dispozitë në mënyrë shprehimore parasheh se: *“Nëse të paditurit i është dorëzuar padia dhe thirrja për përgjigje në padi, se themelësia e kërkesëpadisë del nga faktet treguara në padi dhe se faktet në të cilat mbështet kërkesëpadia, nuk janë në kundërshtim me provat të cilat i ka propozuar vet paditësi, apo me faktet e ditura botërisht”*.

Gjykata nga provat të cilat i janë bashkëngjitur padisë dhe atë: kontrata e punës e lidhur në mes paditëses dhe të paditurës më datë të protokollit 01.09.2020, lista e pagave për vitin 2021 (periudha 01.11.2021-30.11.2021) dhe lista e pagave për vitin 2022 (periudha 01.04.2022-30.04.2022), gjykata ka vërtetuar faktin se paditësja ka punuar si mësimdhënës në Sh.F.M.U. “S. V.”, në fshatin P., K. e D., pra për këtë periudhë ka qenë e punësuar tek e paditura, po ashtu ka vërtetuar se paga bazë për të njëjtën gjatë viteve 2021 dhe 2022 ka qenë 421,00 €. Po ashtu, gjykata bazuar në Indeksin e Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit i publikuar nga Agjencia e Statistikave të Kosovës, ka vërtetuar se shkalla e inflacionit për vitin 2021 ka qenë 3.4%, ndërsa për vitin 2022 ka qenë 11.6%.

Gjykata gjen se në rastin në fjalë duhet të zbatohen dispozitat e dy Kontratave Kolektive të Arsimit në Kosovë (KKAK), të nënshkruar në mes të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës, asaj të vitit 2017 (e aplikueshme nga data 18.04.2017-21.01.2021) dhe asaj të vitit 2021 (e aplikueshme nga data 22.01.2021-22.11.2022), ku në nenin 35 par.10 të të njëjtave përcaktohet se *“Për çdo vit të përcillet shkalla e inflacionit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës dhe përqindja*

(%) e inflacionit të futet në pagë”, ashtu që gjykata erdhi në përfundim se në rastin konkret paditëses i takon e drejta në pagesën mbi bazën e përqindjes së inflacionit, si në dispozitivit të këtij aktgjykimi, pasi që një dispozitë e tillë është e karakterit imperativ dhe si e tillë do të duhej që shkalla e inflacionit të llogaritet në pagë, marrë parasysh që nga lista e pagave që gjendet në shkresat e lëndës, nuk rezulton që një pagesë e tillë është kryer nga e paditura.

Sa i përket lartësisë së kërkesëpadisë, gjykata vendosi duke pasur parasysh të dhënat e nxjerra nga Enti i Statistikave të Kosovës sa i përket shkallës mesatare vjetore të inflacionit, sipas përlllogaritjes si në vijim:

- Për periudhën janar-dhjetor 2021, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 3.4%, andaj duke e llogaritur për vitin 2021 pagën 421,00 €, i bie që shuma e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë për periudhën 12 mujore në total të jetë 171,76 €, apo 14,31 € për muaj ($421 \cdot 3,4\% \cdot 12 = 171,76$) dhe

- Për periudhën janar-nëntor 2022, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 11.6%, andaj duke e llogaritur pagën bazë të paditëses e cila në vitin 2022 ka qenë 421,00 €, atëherë i bie që shuma e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë për periudhën 11 mujore në total të jetë 537,19 €, apo 48,83 € për muaj ($421 \cdot 11,6\% \cdot 11 = 537,19$).

Edhe pse përlllogaritja e përqindjes së inflacionit duhet të bëhet sipas shtimit dinarik ndër vite, gjykata në rastin konkret vendosi si në dispozitiv brenda kufijve të kërkesës së palës konform nenit 2.1 të LPK i cili përcakton se: *“Në procedurë kontestimore gjykata vendos brenda kufijve të kërkesave që janë parashtruar nga palët ndërgjyqëse”*.

Andaj, gjykata vlerëson se nga provat e lartcekura del baza dhe lartësia e kërkesëpadisë, andaj në kuptim të nenit 150 i LPK-së, e në lidhje me dispozitat nga neni 245 paragrafi 1 i Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD), ku përcaktohet se: *“Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbushë atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij”*, erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paraqitur nga ana e paditëses është e bazuar dhe në këtë rast e njëjta u aprovua në tërësi si e themeltë, duke obliguar të paditurën në pagimin e detyrimit sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Lartësia e kamatës së përcaktuar prej 8%, i referohet nenit 382 të LMD dhe kamata është llogaritur nga dita e parashtrimit të padisë.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale u mor sipas nenit 449 dhe 452 par. 1 të LPK, me ç’rast paditëses iu pranua shuma e shpenzimeve në vlerë prej 228,00 €. Lartësia e shpenzimeve të aprovuara i referohet shpenzimeve për pagesën e taksës gjyqësore në vlerë prej 20,00 €, për përpilimin e padisë shuma prej 104,00 €, si dhe për përpilimin e precizimit të kërkesëpadisë shuma prej 104,00 €.

Prandaj, gjykata bazuar në arsyet e cekura më lartë, bazuar në nenin 143 lidhur me nenin 150 par.1 të LPK, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE PEJË

Dega në Deçan

Departamenti i Përgjithshëm

C.nr.699/22, më 08.03.2024

Gjyqtar

Bajram Cacaj

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 ditësh, nga dita e marrjes në dorëzim, Gjykatës së Apelit të Kosovës, përmes kësaj gjykate.

Ankesa duhet të paraqitet në ekzemplarë të mjaftueshëm për palët dhe gjykatën.